



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KURBIN
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Laç, më _____.____.2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Shembja e detyruar e 6 ndërtesave pronë private/kolektive dhe kopshtit Nr.2 Mamurras, të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, në kuadër të procesit të rindërtimit”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7 (Punë).

VLERA E FONDIT LIMIT: 25,161,019 (njëzet e pesë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e nëntëmbëdhjetë) lekë.

Ne mbështetje të Ligjit Nr.97/2019 “Per miratimin e Aktit Normativ, me fuqine e Ligjit,Nr.9,date 16.12.2019, te Keshillit te Ministrave, “Per perballimin e pasojave te fatkeqsise natyrore” , Vendimit Nr. 225, date 12.04.2021 “Per miratimin e dokumentave standarte te tenderit per mallra, pune, sherbime per procedure e prokurimit “Procedure e pershpejtuar”, për këtë procedurë prokurimi u përdorën dokumentat standarte të tenderit “Procedure e pershpejtuar-Rindertimi Pune” dhe konkretisht të llojit “Tender i kufizuar ne kuader te rindertimit” te miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Afati i punimeve do te jete: 2 (dy) muaj.

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 42 të Aktit Normativ.
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet përgjegjëse.

Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rasti se kemi grupe operatorësh ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të dorëzojë vetdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.

Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim grup operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohet:

Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Shënim: Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore sipas përcaktimit në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në VKM nr. 225 datë 12.04.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.199, datë 04.03.2020 “Për miratimin e dokumentave standarte”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndyshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kurbin** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (Kjo shtojce do paraqitet ne fazen e II)*
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4;*
- c. Sigurim oferte sipas Shtojcës 5; Ofertuesit ose kandidatët e kualifikuar duhet të paraqesin sigurimin e ofertës, në vlerën 2% të vlerës së fondit / vlerës së përafërt të kontratës, të përcaktuar në dokumentet e tenderit, 503,220 (pesëqind e tre mijë e dyqind e njëzet) Lekë.*
- ç. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- d. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;*
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojces 11;*
- e. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 12;*
- f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve/makinerive sipas Shtojcës 13;*
- g. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas aktit normative sipas Shtojcës 14;*
- gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe VKM nr. 225 datë 12.04.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.199, datë 04.03.2020 “Për miratimin e dokumentave standarte”.

1.1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1.1.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 10.

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe si dhe VKM nr. 225 datë 12.04.2021 "Për një ndryshim në vendimin nr.199, datë 04.03.2020 "Për miratimin e dokumentave standarte".

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përllogaritur e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e përllogaritur të kontratës të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e kërkuara, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: *“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që verteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2022 (sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin 9632/2006 ” Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nëni 3.1/a, b, c dhe nëni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

I) Për kontrata të realizuara me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 12, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.

II) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Akt kolaudimi objekti;
- Fatura tatimore përfundimtare/ose cdo situacion.

***Pika 2.3.1/a,** plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Shënim: Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vleren 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- NP-1 A Punime gërmimi në tokë

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- NS-1 B Punime për prishjen e ndertimeve
- NS-18 A Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton *"Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.."* Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin

garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1 A	Punime gërmimi në tokë	Sipas preventivit dhe relacionit cdo objekt qe do prishet perfshin punime germimi.	Niveli A	0 – 20 milion lekë
NS-1 B	Punime per prishjen e ndertimeve	Zeri nr.1, 2, 3, 4, 5	Niveli B	21 – 50 milion lekë
NS-18 A	Punime topogjeodezike	Punime topogjeodezike Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri	Niveli A	0 – 20 milion lekë

		terrenesh Sipas zerave te preventivit dhe relacionit kemi punime te tilla.		
--	--	--	--	--

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** të përfshirë në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi 1 (një)

Per Inxhinierin e mësipërm duhet të paraqesë Kontratën e punës, Diplomën si dhe te jete i siguruar dhe të figurojë në listëpagesat perkatese E-Sig për të paktën **muajn e fundit** (*periudhen e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave*).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Inxhinieri i ndërtimit është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Eshtë kërkuar inxhinier ndertimi për zbatimin e punimeve ne perputhje me zerat e punimeve te preventivit , specifikimeve teknike qe do te zbatohen dhe si dhe kategorive perkatese ne licencen perkatese te zbatimit, Inxhinieri ndertimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve.

Referuar kohezgjatjes se kerkuar te Inxhinierit për të paktën **muajn e fundit** (*periudhen e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave*), sqarojme se: Procedura e prokurimit e sipercituar konsiderohet nje procedure e pershpejtuar, dhe ralizimi i ketyre punimeve duhet te behet ne kohe dhe ne cilesine e duhur. Theksojme se rasti konkret ka te beje me shkaktimin e pasojave te renda nga fatkeqsi natyrore dhe prishja e objekteve kerkon aftesi dhe cilesi, pasi objektet qe do prishen jane ne zona te banuara.

Prania e stafit teknik per afat te caktuar ne listepagesa i verteton AK se operatori ekonomik ka nje staf te qendrueshem, operativ i cili do te kryeje punimet ne kohe dhe me cilesi. Qëndrueshmëria e Ing.Ndertimit ne punë me kohështirje **muaj e fundit**, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën.

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmerisht drejtues teknik ne licencen e shoqerise) si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi– 1 (një)
- Inxhinier Elektrik – 1 (nje)
- Inxhinier Topograf – 1 (një)
- Inxhinier Mekanik – 1 (një)

Operatori ekonomik per stafin e mësipërm duhet te paraqese kontratat e punes, si dhe te të figurojnë ne listepagesa e shoqerise per te paktën **muajn e fundit** (*periudhen e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave*).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin mbeshtetes, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për kete staf në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Inxhinieret janë përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Referuar kohezgjatjes se kerkuar për të paktën muajn e fundit sqarojme se: Procedura e prokurimit e sipercituar konsiderohet nje procedure e pershpejtuar, dhe ralizimi i ketyre punimeve duhet te behet ne kohe dhe ne cilesine e duhur. Theksojme se rasti konkret ka te beje me shkaktimin e pasojave te renda nga fatkeqsi natyrore dhe prishja e objekteve kerkon aftesi dhe cilesi, pasi objektet qe do prishen jane ne zona te banuara. Staf i kerkuar eshte bazuar ne punimet qe do kryhen dhe nevoiten per te ndare punen, organizusr punen, kontrolluar dhe dokumentuar punimet per cdo objekt, ndjekjen hap pas hapi e cecurise se punime si dhe mbrojen e mjedisit dhe sigurise ne pune.

Prania e stafit mbeshtetes per afat te caktuar ne listepagesa i verteton AK se operatori ekonomik ka nje staf te qendrueshem, operativ i cili do te kryeje punimet ne kohe dhe me cilesi. Qëndrueshmëria e stafit ne punë me kohështrirje **muajn e fundit** (*periudhen e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave*), tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën me sukses.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- **1 (nje)** punonjës pergjegjes, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jete i pajisur me certifikaten te Trajnimit për **”Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”**, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, i cili duhet te figuroje ne listepagese per periudhen e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështet në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Qëndrueshmëria në punë me kohështirje për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën me sukses.

2.3.6 Operatori ekonomik të ketë në stafin e punonjesve të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik nga ISHTI/diploma/ certifikata te leshuar nga institucione te akredituara sipas legjislacionit ne fuqi, si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqërisë për te pakten për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave punonjesit si me poshte:

- Teknik/Specialist Ndertimi - 1
- Mekanik – 2
- Elektracist – 5
- Hidraulik – 5
- Karpentier - 3
- Punonjes punime në lartesi – 5
- Murator – 5
- Suvatues – 5

Për punonjësit e mësipërm të paraqiten, diplome ose certifikate ose dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, si dhe kontratat te punës të vlefshme. Specialistet e mesiperm duhet te figurojne ne listepagesat e shoqërisë për te pakten **per periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar gjithashtu duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur Autoriteti Kontraktor në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Sqarojme se Teknik/Specialist Ndertimi nevojitet pasi organizon punën në cdo objekt. Mekaniku është për mirembajtjen e mjeteve. Elektracist janë kerkuar pasi nevojiten për ndërprej/lidhjen për me ndjek problemet lidhur me furnizimin me energji elektrike. Hidraulik për zmontimin e paisjeve

hidrosanitare. Karpentier per vendosjen, levizjen, mirembajtjen e skelerise. Punonjes punime ne lartesijane te domosdoshem pasi do te punohet ne lartesi. Murator dhe sovatures jane kerkuar pasi nevoiten per punime te ndryshme. Punetoret e mesiperm jane kerkuar te kualifikuar pasi kemi te bejme me shembje objektesh dhe siguria ne kantier eshte primare.

2.3.7 Të ketë në stafin e punonjesve të pajisur me deshmi aftesimi profesional nga Institucionet shteterore si edhe patente perkatase per punojesit e meposhtem:

- Shofer - 4

- Manovrator 2

Për punonjësit e sipërpërmendur të paraqiten, deshmitë e aftesise profesionale per manovratorët, lejet e drejtimit per shoferët, si dhe kontratat te punës të vlefshme. Specialistet e mesiperm duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise ose te kontraktuar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar ne kontrata te tjera dhe do te jete i pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne objekt. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma.

Shënim: *(Në rastin e Bashkimit të operatorëve ekonomik secili operator ekonomik duhet te percaktojte me ane ten je deklarate Drejtuesin Teknik te punimeve ne objekt, i cili duhet te jete i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar ne kontrata te tjera dhe dote jete i pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas perqindjes se bashkepunimit)*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ne nenin 39, pika 6, gërma c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Eshte vendosur ky kriter duke u bazuar ne ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, pasi per cdo objekt zbatimi duhet te kete drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij ne perputhje me kete ligj dhe vendim Nr.312, datë 5.5.2010 ”Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Gjithashtu sqarojme se eshte kerkuar qe nese kemi BOE secili te deklaroje Drejtuesin Teknik, pasi kemi te bejme me shembje objektesh ne zona te banura dhe siguria ne kantier eshte primare.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **90 (nëntëdhjetë)** punonjes, **për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave** e vertetuar kjo me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj.
- b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqine punetore është bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe është perlllogaritur ne nje afat kohor prej 2 muaj pra 60 (gjashtedhjetë) dite i cili kerkon fuqi punetore dhe mjete per zbatimin me sukses te kesaj kontrate. Kapaciteti per fuqi punetore i kerkuar ne kete kerkese per kualifikim bazohet në K.Punës, legjislacionin për sigurimet shoqërore (pushimet, leje e zakonshme).

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Afati i realizimit te punimeve është 60 (gjashtedhjetë) dite. Sqarojme se nga llogaritja e preveventivit sipas analizave teknike duhen 5400 dite pune / per afatin kohor prej 60 ditesh = 90 punonjes.

Në përcaktimin e numrit te punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje **për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave**, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimre e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësi a	Sasia

1	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës (mbi 15 ton)	në pronësi / qera	copë	3
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës (1 -3.5 ton)	në pronësi / qera	copë	2
3	Kamion me Vinc	në pronësi / qera	copë	1
4	Eskavator me goma/zinxhire	në pronësi / qera	copë	2
5	Autobot uji	në pronësi / qera	copë	1
6	Rimorkiator (koka terheqese + gjysem rimorkio)	në pronësi / qera	copë	1
7	Matrapik dore	në pronësi / qera	copë	5
8	Gazogjen	në pronësi / qera	Copë	3
9	Gjenerator	në pronësi / qera	copë	3
10	skeleri	në pronësi / qera	m2	2000

Mjetet e lartpërmendura duhet të jenë në pronësi ose me qera dhe ofertuesi duhet të paraqesë deklarinimin për disponimin e makinerive (sipas shtojcës 13) të shoqëruar me dokumentat e mëposhtëm:

- a) Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistrat publike duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash (e vlefshme), si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe të jetë e dukshme targa e mjetit.
- b) Për mjetet e deklaruara me qera që shënohen në regjistrat publike duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash (e vlefshme), si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe të jetë e dukshme targa e mjetit.
- c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në perfundimin e plotë të punimeve.
- d) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes. Për pajisjet të marra me qera, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi, kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes që vërteton pronësinë e pajisjes, si dhe të paraqesë foto të qarta për secilin pajisje teknike.

I. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklarohet se mjetet dhe pajisjet e deklaruar sipas shtojcës 13 nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera si dhe deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë mbi vendodhjen e mjeteve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qera janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës.

Numri i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme:

- ISO 9001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të cilesisë*) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 14001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë .
- ISO 45001-2018 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar duhet të paraqesë çertifikatat e mësipërme).

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatoreve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.4.2. Grafiku i punimeve, Preventivi. (Do paraqiten në fazën e II).

Sqarim për operatorët ekonomikë: Në bazë të ligjit Nr.87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” si dhe Njoftimit të përbashkët të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Nr.25366 Prot, datë 30.12.2020 dhe Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.8480 Prot, datë 30.12.2020, Autoriteti Kontraktor Bashkia Mirdite informon se për nënshkrimin e një kontrate në përfundim të procedurës, operatori ekonomik duhet të ketë:

- *Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin, për Tatimpaguesit që përdorin Platformen Qendrore të Faturave.*
- *Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Çertifikuar për zgjidhjen softwerve-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes software-ike.*
- *Vetedeclarim i postës zyrtare elektronike të subjektit.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Lidhur me realizimin e kesaj kontrate AK i ka shprehur qarte ne relacionin dhe specifikimet teknike te gjithë proceset e punes qe kerkon te realizoje si kerkesat per cilesine e te gjithë punimeve dhe materialeve qe do te perdoren per realizimin me sukses te kontrates.

Ne specifikimet teknike qe jane hedhur ne dokumentet teknike te tenderit nuk eshte përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i proçedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT:

1. _____ Kryetar (Përsoni përgjegjës)
2. _____ Anëtar
3. _____ Anëtar